



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/21
Datë: 28.07.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 korrik 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Procesverbali dhe Transkripti i mbledhjes së 16-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/21

Datë: 28.07.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 korrik 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Punimet nga Metalet e Çmuara.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/21
Datë: 28.07.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 korrik 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Amendamentimit të Marrëveshjes së Bashkëfinancimit për Projektin "Programi Mbështetës për Ujësjetës dhe Kanalizim në Zonat Rurale Faza (dalëse) VI", ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/21

Datë: 28.07.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-221, Ligjin Nr.04/L-194, Nr.05/L-063, dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 korrik 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti gjashtëmujor i Buxhetit për vitin 2021.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi ta dorëzoj në Kuvendin e Kosovës konform kërkesave të nenit 45 të Ligji 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/21

Datë: 28.07.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 46 të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 korrik 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Ri-aprovohet Raporti Vjetor Financiar për vitin 2020.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi ta dorëzoj në Kuvendin e Republikës së Kosovës, konform kërkesave të nenit 46 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 06/06 i datës 13.04.2021.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/21
Datë: 28.07.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 59 të Ligjit Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-158, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 korrik 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e pesë (5) anëtarëve të Bordit në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale në këtë përbërje:
 - 1.1. Sami Dvorani, kryesues;
 - 1.2. Fadile Dyla, Zv.Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtare; dhe
 - 1.3. Irfan Lipovica, Zv.Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, anëtar.
2. Obligohet Komisioni ad hoc nga pika 1. e këtij vendimi që t'i kryej punët dhe detyrat në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-158.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/21

Datë: 28.07.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt, duke u bazuar në nenin 4, të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 korrik 2021, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 15/158 të datës 29.11.2013

1. Pika 3. e Vendimit Qeverisë Nr. 15/158, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 29.11.2013, ndryshohet si në vijim:

3. Bartësit e dokumenteve të udhëtimit për të huaj dhe dokumenteve valide të udhëtimit të lëshuara në bazë të Konventës për Statusin e Refugjatit (1951) dhe Konventës për Statusin e Personave pa Shtetësi (1954), të lëshuara nga vendet anëtare të BE-së dhe Zonës Schengen, si dhe Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda Veriore, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanadaja, Australia, Japonia, Zelanda e Re, lirohen nga nevoja për t'u pajisur me vizë kosovare për hyrje, transit dhe qëndrim në territorin e Republikës së Kosovës deri në 15 ditë pa vizë.

2. Pika 4. e Vendimit Nr. 15/158, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 29.11.2013, të plotësohet si në vijim:


3. Shtetasve të:

Shteteve anëtare të BE-së;
Shteteve anëtare të Zonës Schengen;
Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës Veriore;
Selisë së Shenjtë;
Principatës së Andorës;
Principatës së Monakos;
Republikës së San Marinos;
Republikës së Shqipërisë;
Republikës së Malit të Zi; dhe
Republikës së Serbisë.

Iu lejonet hyrja transiti dhe qëndrimi deri në 90 ditë për një periudhë gjashtëmujore (6), me letërnjoftim biometrik valid.

4. Shtojca 1. e Vendimit Nr. 15/158, të datës 29.11.2013, ndryshohet duke hequr asteriksin nga Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda Veriore, si shenjë dalluese për vendet anëtare të BE-së.
5. Pjesët e tjera të Vendimit Nr. 15/158, të datës 29.11.2013, Vendimit Nr. 08/167 të datës 22.01.2014, si dhe Vendimit Nr. 14/55, të datës 06.07.2018, mbeten në fuqi.
6. Obligohen Ministria e Punëve të Brendshme/Policia e Kosovës dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Republikës së Kosovës, për zbatim të këtij vendimi.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/21

Datë: 28.07.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 korrik 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete buxhetore në shumë prej "katërqindetridhjetë mijë euro" (430,000.00 €) për Ministrinë e Shëndetësisë për pagesën e Specializantëve për muajin Korrik 2021.
2. Mjetet e ndara sipas paragrafit 1. të këtij vendimi merren nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike nën-programi "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere"
3. Mjetet sipas pikës 2. të këtij vendimi transferohen në Ministrinë e Shëndetësisë në kod 206 në nën-programin "Aftësimi Specialistik dhe EVM" me kod 90300, në kategorinë e shpenzimeve "Paga dhe Shtesa".
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/21
Datë: 28.07.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 korrik 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete buxhetore në shumë prej "pesë milion euro" (5,000,000.00 €) për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021, Pakoja e Ringjalljes Ekonomike Masa 2.5.
2. Mjetet e ndara sipas paragrafit 1. të këtij vendimi merren nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike, nën-programi "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet sipas pikës 2. të këtij vendimi transferohen në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me kod 203, në nën-programin "Departmenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve" me kod 40100, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
4. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/21

Datë: 28.07.2021

Në mbështetje të nenit 92, paragrafit 4 dhe të nenit 93, paragrafit 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4, paragrafin 2, nën paragrafin 2.1 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 korrik 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Pezullohet përkohësisht së zbatuari neni 22 (Shtojca1) i Rregullores (QKR) Nr. 02/2020 për pagat, shtesat mbi pagë dhe kompensimet tjera në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës, deri në plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Mbrojtjes që sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi të përgatis dhe t'ia propozojë Qeverisë për miratim Projekt-Rregulloren për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores (QRK) Nr. 02/2020 për pagat, shtesat mbi pagë dhe kompensimet tjera në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës.
3. Obligohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/21
Datë: 28.07.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 korrik 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Aneksit për ndryshimin e Shtojcës II. 1. të Marrëveshjes të Tregtisë së Lirë ndërmjet Republikës së Turqisë dhe Republikës së Kosovës, lidhur me përkufizimin e konceptit të produkteve origjinuese dhe metodat e bashkëpunimit administrativ.
2. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë që të zhvilloj negociata me Republikën e Turqisë, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të Aneks-marrëveshjes së lartcekur në pajtim me Kushtetutën së Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/21
Datë: 28.07.2021

Në mbështetje të nenit 92, paragrafit 4 dhe të nenit 93, paragrafit 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, si dhe Planin e Punës së Qeverisë për vitin 2021, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 korrik 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemës së Grantit të Bazuar në Performancë.
2. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal që konform Koncept-dokumentit të ndërmarr veprimet për zbatim të opsionit të rekomanduar.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/21
Datë: 28.07.2021


Në mbështetje të nenit 92, paragrafit 4 dhe të nenit 93, paragrafit 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 pika 6 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 korrik 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rialokimi i mjeteve financiare në shumë prej pesëqind mijë euro (500.000,00 €), në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal me kod 212, nën-programi Administrata Qendrore me kod 11312, nga kategoria shpenzime kapitale, konkretisht nga projekti: "Programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndër-komunal" me kod 15633 në njëmbëdhjetë (11) marrëveshjet e mirëkuptimit për projekte kapitale të nënshkruara nga Ministri i MAPL-së dhe Kryetarët e Komunave.
2. Mjete nga pika 1. e këtij vendimi rialokohen nga projekti: "Programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndër-komunal" me kod 15633 në këto projekte të reja, konform shumave të cekura si në vijim:
 - Projekti "Rregullimi i kanalizimit në lagjen e komunitetit pakicë dhe asfaltimi i rrugicave në fshatin Gadime" në Komunën e Lipjanit në vlerë prej 40,000.00 €;
 - Projekti "Ndërtimi i rrugëve në lagjen e komuniteteve" në Komunën e Rahovecit në vlerë prej 48,000.00 €;
 - Projekti "Asfaltimi i rrugëve Videjë-Jagodë-Budisalc-Berkovë dhe në Klinafç" në Komunën e Klinës në vlerë prej 50,000.00 €;
 - Projekti "Ndërtimi i kolektorit të ujërave atmosferike" në Komunën e Podujevës në vlerë prej 48,000.00 €;
 - Projekti "Ndërtimi i rrugëve në lagjen 2 Korriku" në Komunën e Mitrovicës Jugore në vlerë prej 40,178.00 €;
 - Projekti "Rikonstruktimi i rrugës Meshari-Fushë Kosovë" në Komunën e Fushë Kosovës në vlerë prej 50,000.00 €;
 - Projekti "Asfaltimi i rrugëve të minoriteteve në qytetin e Pejës dhe fshatra" në Komunën e Pejës, në vlerë prej 50,000.00 €;
 - Projekti "Rregullimi i hyrjeve banesore" në Komunën e Kamenicës në vlerë prej 42,822.00 €;
 - Projekti "Ndërtimi dhe sanimi i rrugëve me kubëza betoni për lagjet e komuniteteve" në Komunën e Gjakovës në vlerë prej 40,000.00 €;
 - Projekti "Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe ndriçimi publik në lagjen Arif Ademi në Banjë dhe asfaltimi i rrugëve në Komunën e Istogut" në Komunën e Istogut, në vlerë prej 50,000.00 €;

- Krijimi i hapësirave/infrastrukturore për persona me nevoja të vecanta në Komunën e Skenderajt në vlerë prej 41,000.00 €.
- 3. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, për zbatimin e këtij vendimi.
- 4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/21
Datë: 28.07.2021

Në mbështetje të nenit 92, paragrafit 4 dhe të nenit 93, paragrafit 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 pika 6 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 korrik 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rialokimi i mjeteve në shumë prej njëqindpesëdhjetë mijë euro (150,000 €) , në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal me kod 212, nën-programi Administrata Qendrore me kod 11312, nga kategoria e shpenzimeve kapitale konkretisht nga projekti: "Programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndërkomunal" me kod 15633 në projektin kapital "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit" në Komunën e Deçanit në përputhje me marrëveshjen e mirëkuptimit të nënshkruar nga Ministri i MAPL-ës dhe Kryetari i Komunës së Deçanit.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi rialokohen nga projekti: "Programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndërkomunal" me kod 15633 në projektin e ri "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit" në Komunën e Deçanit, në vlerë prej 150,000.00 €.
3. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Financave, Punëve dhe Transfereve, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë